



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA / POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO

Hajveri Prishtinë

Nr. / Br. 04-052-1201/2

Data / Datum 23.11.2022



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
OEVERIA - VLADA - GOVERNMENT



MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA - MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA - POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT - ODELJENJE ZA INSPEKCIJE - DEPARTMENT OF INSPECTION

Referencë: IPK/21112022/DI

Datë: 21.11.2022

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 21/2015 për Inspektime në Policinë e Kosovës, Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzuesin për procedurën e planifikimit, inspektimit e raportimit dhe Planin Zhvillimor Strategjik të IPK-së (2022-2024), Departamenti i Inspektimeve të IPK-së nxjerrë këtë:

RAPORT I INSPEKTIMIT

Titulli - objekti	- Menaxhimi i thirrjeve dhe reagimit policor
Referenca	- 07/2022
Data e inicimit	- 01.07.2022
Data e raportimit	- 21.11.2022
Arsyet e inicimit	- Inspektimi në këtë fushë të menaxhimit është paraparë me Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta (nr. 04-052-261/9, datë 14.02.2022).
Objektivi	- Matja dhe analiza e kohës së reagimit policor, nga momenti i pranimit të thirrjeve, deri në arritjen e njësisve policore në vendngjarje.
Metodologjia	- Takime - intervista me 41 drejtues dhe bartës funksionesh: (a) Komandantët e stacioneve policore, (b) Shefat e operativës së stacioneve, (c) Mbikëqyrësit e ndërrimeve, (d) Zyrtarë në Bazat e Komunikimit, - Këqyrje - verifikime të radio - logjeve (123 logje mujore operacionale); - Plotësimi i formularëve mbi analizën e 15.105 mostra ngjarjesh; - Marrje dokumentesh (raporte, logje operacionale, etj.).
Subjekti	- Stacionet policore në kuadër të drejtorive rajonale policore (41 sosh) Divizioni i Sigurisë Publike - Departamenti për Operacione.
Afatet e inspektimit	- Fillimi - 13.07.2022; - Përfundimi - 26.07.2022; - Periudha e mbulimit - Tre muajt e fundit të vitit (prill, maj, qershor).
Kriteret vlerësuese (standardet)	- Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë, - PSO - Koha e reagimit (7 shtator 2018), - Udhëzuesi për zbatimin dhe monitorim të programit të besueshmërisë dhe kënaqshmërisë së publikut.
Ekipi realizues	- Shqiponjë Sopi, udhëheqëse e inspektimit, - Kadri Keçmezi, inspektor, - Kushtrim Jonuzi, inspektor, - Mirsad Puçurica, inspektor, - Servet Tasholli, inspektor, - Teuta Rukolli - Ajeti, inspektor.

Mbikëqyrur nga	- Ilir Idrizaj, Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
Mbështetur nga	- Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
Dorëzuar nga	- Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miratuar nga	- Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i JPK-së
Datë	- 21.11.2022



Faktet kyçe



Reagimi policor

Koha e përgjithshme mesatare në nivel vendi

13.76 minuta

Reagimi më i shpejtë

Drejtoria Rajonale
Ferizaj

Stacioni Policor
Ferizaj

9.12 minuta

8.49 minuta



Ecuria e reagimit (në minuta)

Përgjigjja në rast

Caktimi i detyrës

Arritja në vendngjarje

2.15

11.61



Reagimi sipas zonave (në minuta)

Koha e përgjithshme e reagimit

Urban

Rural

11.62

20.79

Reagimi me kohë



Totali i mostrave

15.105

Reagimi brenda limiteve (mostra)

12.091

80.05%

Vonesat në reagim (mostra)

3.014

19.95%

Reagimi sipas tipit të thirrjes (në minuta)



Aksident

11.42

Komunikacion

13.28

Incident

13.95

Tjera

13.69

Vepra penale

17.04



Reagimi për llojet më të shpeshta të veprave penale (në minuta)

Kanosje

Narkotik

Sulm

Dhunë në familje

Vjedhje

12.98

14.1

14.5

15.3

18.3

Përmbledhje ekzekutive dhe rekomandimet

Inspektimi nxjerrë në pah se:


- ✚ *Koha e reagimit policor në thirrjet e qytetarëve, përgjithësisht (në masë të madhe) konsiderohet të jetë brenda limiteve kohore, të përcaktuara me politikat dhe synimet e Policisë së Kosovës.*
- ✚ *Nga matjet e përgjithshme rezulton se Policia e Kosovës ka pasur reagimet më të shpejta për thirrjet e qytetarëve të tipit “aksident”, kurse brenda tipit të thirrjeve “vepër penale”, koha e reagimit ndryshon varësisht prej natyrës së veprës dhe nevojës për reagim me prioritet.*
- ✚ *Koha e reagimit nga stacionet sfidohet nga ndikimi i një sërë faktorësh, përfshirë: mungesën e burimeve njerëzore, numrin e pamjaftueshëm të automjeteve, problemet me radio - komunikimin, vështirësitë në funksionimin e duhur të internetit, konfiguracionin gjeografik, etj.*
- ✚ *Për shkak të dobësive të identifikuara në mbajtjen e logut operacional, trajnimet konsiderohen instrument me rëndësi për unifikimin (standardizimin) e metodologjisë së mbajtjes së evidencës së ngjarjeve dhe aktiviteteve, si dhe ngritjen e cilësisë së evidencave (logut operacional).*



Bazuar në gjetjet, përfundimet dhe nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve:

1. *IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Operacione që të hartojë udhëzues mbi procedurën dhe veprimet e stacioneve, nga momenti i thirrjes, ndarja e detyrës, arritja në vendngjarje dhe raportimi, për të eliminuar dobësitë evidente që reflektojnë nga inspektimi.*
2. *IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve, shefave të operativës dhe mbikëqyrësve të ndërrimeve, të ushtrojnë kontrole të shtuara, duke përfshirë auditime të planifikuara periodike mbi zyrtarët që mbajnë logun, drejt ngritjes së cilësisë së evidencave.*
3. *IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Divizionit të Sigurisë Publike (Departamenti për Operacione), që në koordinim me komandantët e stacioneve të organizojnë trajnime të përbashkëta lidhur me mbajtjen e evidencave cilësore (logut), për t'u siguruar se personeli aplikon metodologji unike të regjistrimit në log.*
4. *IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, si dhe Drejtorit të Departamentit për Shërbime Mbështetëse, që të analizojnë faktorët që sfidojnë reagimin e duhur policor dhe të ndër marrin veprimet konkrete drejt sigurimit të burimeve të nevojshme (njerëzore dhe logjistike).*
5. *IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve dhe shefave të operativës, që të monitorojnë dhe analizojnë kohën e reagimit policor dhe rezultatet t'i dokumentojnë përmes raporteve periodike.*

Gjetjet kryesore:



1. Performanca policore në përgjigje të thirrjeve të qytetarëve (reagimi)

1.1. Policia gjatë punës së përditshme mbledhë informata të ndryshme, që mund shpijnë në ngritje të situatës së sigurisë dhe krijimin e një ambienti më të qetë për qytetarët. Numër i madh informatash janë thirrje të qytetarëve dhe institucioneve që kërkojnë reagim policor, si përgjigje në ngjarjet që kanë ndodhur apo pritet të ndodhin. Informatat e tilla (thirrjet) kërkojnë trajtim dhe duhet ndjekur rrugën e duhur të qarkullimit të tyre brenda institucionit, në mënyrë që të reagohet sa më shpejtë. Drejtoritë Rajonale Policore (DRP) kanë rregulluar sistemin komunikues për komunikim të brendshëm/jashtëm në formë të shkruar, verbale e elektronike.

1.2. Në kuadër të drejtorive rajonale policore funksionojnë gjatë tërë kohës (24/7) Qendrat Operative Komunikuese Rajonale (QOKR), si qendra komunikuese dhe koordinuese të të gjitha aktiviteteve operative që kryhen nga zyrtarët policor në kuadër të zonës së përgjegjësisë. QOKR është qendër grumbullimi - shpërndarëse e informatave për të gjitha incidentet që ndodhin brenda zonës së përgjegjësisë, atyre që vijnë nga Qendra Operative e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë dhe qendrave - stacioneve të rajoneve tjera¹. Sa i përket koordinimit, QOKR-ja mbanë kontakte të vazhdueshme dhe koordinon punën me stacionet policore, njësitë në kuadër të DRP-së, shërbimet komunale dhe agjencitë tjera në nivel lokal, rajonal dhe qendror.

1.3. QOKR ka personel të angazhuar në administrimin e informatave dhe thirrjeve dhe lidhur me to mbanë evidenca përmes bazës së të dhënave të instaluar në qendër komunikimi. Qendra mban regjistrin e logut ditor të veprave penale, incidenteve dhe informatave tjera. Në njërën nga vizitat që i është bërë njëerës prej QOKR-ve, IPK - ja është njoftuar se thirrjet në QOKR pranohen përmes numrit kujdestar 192, si dhe shërbimit emergjent në numrin kujdestar 112. Është hapur dhe aplikacioni online - Lajmëro Policinë, ku thirrjet e pranuar në formë të shkruar, evidentohen në sistem. Sapo të pranohet informata nga dispeçeri, automatikisht krijohet në sistem një dosje mbi ngjarjen, që gjeneron numrin identifikues si numër i thirrjes. QOKR varësisht zonës ku ndodhë ngjarja, ia bartë thirrjen stacionit përkatës. Sistemi i komunikimit duke mbledhur informatat, kërkon një sërë të dhënash të nevojshme, që pasqyrohet si log i ngjarjeve ditore. Nga intervista e kryer me zyrtarë të QOKR - ve, IPK është njohur se logu i ngjarjeve ditore në formën e tanishme (logu operacional) ka filluar të aplikohet nga korriku i vitit 2019, informatat e të cilit janë lehtë pasqyruese².

1.4. IPK-ja ka pasur në fokus punën që bëhet në stacione, duke u interesuar se si transmetohet thirrja nga niveli rajonal tek stacionet, si prioritetizohen ngjarjet, sa shpejt ndahen detyrat nga drejtuesit për reagim në thirrjet e qytetarëve dhe sa janë të shpejta reagimet e stacioneve në vendngjarje. Stacionet policore janë të lidhura online në sistemin e komunikimit, i cili mirëmban logun operacional. Në stacione policore funksionojnë bazat (qendrat) e komunikimit, në të cilat punojnë zyrtarët komunikues, të cilët kryesisht janë shërbyes civil, të shpërndarë në tre (3) ndërrime. Qasja në sistem sigurohet përmes lejekalimeve, ku zyrtarët e caktuar mund të fusin më pas të dhëna mbi reagimin policor. Pas pranimit të thirrjeve, mbikëqyrësit e ndërrimeve janë ata që prioritetizojnë thirrjet dhe ndajnë detyrat te njësitë policore për reagim në thirrjet e qytetarëve. Për dallim nga stacionet tjera policore, Ferizaj nuk ka qendër komunikimi, meqë QOKR - ja është në të njëjtin objekt me stacionin policor dhe informatat për reagim barten drejtpërdrejt tek mbikëqyrësi i ndërrimit në stacion.

¹ Departamenti për Operacione, *PSO - Koha e reagimit*, numri referues DDO-04/085/2018, datë 07.09.2018.

² Logu ditor është pasqyrë e krijuar elektronike apo me shkrim, ku evidentohen informimet telefonike zyrtare, të pranuar nga cildo informues i mundshëm, për një rast apo ngjarje të caktuar, të ndodhur më parë, apo që është në zhvillim e sipër.

1.5. Reagimi me kohë i Policisë është i rëndësishë së veçantë, meqë nga një reagim i duhur mund të varet jeta e qytetarëve të rrezikuar që kërkojnë ndihmë, mund të ruhen gjurmët në vendin e ngjarjes, mund të sigurohen dëshmitarët për nevoja të hetimit, mund të parandalohet ndonjë incident a ngjarje, etj. Në vitin 2020, IPK-ja ka bërë një hulumtim mbi besueshmërinë e kënaqshmërinë e publikut me punën policore, ku ka marrë perceptimet e qytetarëve edhe mbi kohën e reagimit kur ata kanë thirrur Policinë. Rezultatet kanë pasqyruar se 27.8% e të anketuarve që kanë pasur rastin të thirrur Policinë, kanë deklaruar se reagimi policor në përgjigje të thirrjeve të tyre, ka qenë i vonuar (jo me kohë). Kjo shtyri IPK-në që të matë dhe analizojë kohën e reagimit në përgjigje të thirrjeve të qytetarëve. Inspektimi është shtrirë në të gjithë stacionet, nga logjet operationale të cilave janë nxjerrë 15.105 mostra për muajt prill, maj e qershor. Numri i ngjarjeve (thirrjeve) është më i madh për dallim nga mostra e përzgjedhur, por që për shkaqe objektive e subjektive, ka qenë e pamundur të sigurohet mostër më e gjerë, si rezultat i mungesës së të dhënave. Sidoqoftë, kjo mostër është e pasur dhe mundëson krijimin e një opinionimi mbi kohën e reagimit.


1.6. Sipas Udhëzuesit për zbatimin dhe monitorimin e programit të besueshmërisë dhe kënaqshmërisë së publikut, koha e reagimit llogaritet nga pranimi i informatës nga QOKR, mbikëqyrësi, apo Policia në ndonjërin nga format e komunikimit, koha e dhënies së informatës tek patrulla/njësiti që ngarkohet, koha e nisjes së patrullës/njësitisë së ngarkuar dhe arritja në vendngjarje. Nga 15.105 mostra të analizuar, koha e përgjithshme mesatare e reagimit në vendngjarje nga njësitë policore të stacioneve sille të jetë 13.76 minuta (13 minuta e 46 sekonda). Kjo kohë përfshinë periudhën e reagimit nga momenti i pranimit të thirrjes, deri në arritjen e njësive në vendngjarje. Nëse kohën e reagimit e trajtojmë nga këndvështrimi rajonal, Ferizaj dhe Mitrovicë Jugu kanë reagim më të shpejtë krahasuar me drejtoritë tjera rajonale. Gjilani, si dhe Gjakova kanë performuar në nivel të mesatares së përgjithshme, derisa drejtoritë tjera kanë pasur reagim më të shtyrë. Stacionet policore në Ferizaj, Mitrovicë Jugu, Gjakovë e Deçan kanë pasur reagim më të shpejtë policor krahasuar me stacionet tjera (8.49, 11.21, 11.91, 11.93 minuta), derisa Leposaviqi, Dragashi, Zubin Potoku e Novo Bërda kanë performuar më ngathtë (30.69, 28.82, 28.39 dhe 26.09 minuta).

Diagrami 1 - Koha e reagimit policor sipas DRP-ve (në minuta)




1.7. Kur u potencua se nga momenti i pranimit të thirrjes krijohet një vonesë deri në caktimin (ndarjen) e detyrës për njësinë reaguese policore, është normale që zgjatet dhe dalja në vendngjarje. Pas pranimit të thirrjes, drejtoria rajonale bartë thirrjen në stacionin, në zonën e të cilit ndodhë ngjarja. Ndarja e detyrës dallon nga stacioni në stacion. Koha e përgjithshme mesatare e ndarjes së detyrës (caktimit) në nivel të drejtorive rajonale është 2.15 minuta (2 min. 9 sek). DRP-të në Gjilan dhe Ferizaj kanë kohën më të shkurtër të ndarjes së detyrave me 0.59, përkatësisht 1.2 minuta, derisa kohën më të gjatë ka regjistruar DRP - Pejë me 5.8 minuta. Kurse, sa i përket matjeve në nivel stacionesh, Gjilani, Malisheva dhe Mitrovicë Jugu kanë kohën më të shpejtë të caktimit të detyrës. Në anën tjetër, stacionet në Prishtinë Jugu, Dragash dhe Istog kanë regjistruar kohën më të gjatë të ndarjes së detyrës (8.94, 7.41 dhe 7.23 minuta). Siç shihet edhe në diagram, nëse zbritet koha e humbur për caktimin


e detyrës, del se mesatarja e përgjithshme e reagimit policor në nivel të të gjitha drejtorive/stacioneve është 11.61 minuta ($13.76 - 2.15 = 11.61$ minuta). Se cila është koha më e shpejtë e reagimit policor pas ndarjes (caktimit) të detyrës, rezultati sipas stacioneve është i prezantuar në shtojcën 1.




1.8. PSO - Koha e reagimit përcakton që koha e reagimit për zonat urbane të jetë maksimum 15 minuta dhe për zonën rurale, maksimum 30 minuta, varësisht nga lokacioni ku ndodhë rasti (me përjashtime eventuale në disa zona të thella malore dhe me kushte të papërshtatshme atmosferike). Sipas PSO-së, njësi patrullues për t'iu përgjigjur rastit në fjalë, duhet të përpiqet maksimalisht që në afat sa më optimal t'i përgjigjet kërkesës së qytetarit apo nevojës për reagim. Nga 11.571 mostra të reagimit në zona urbane rezulton një mesatare e përgjithshme prej 11.62 minuta në nivel të drejtorive rajonale. Nga 3.534 mostra të reagimit në zona rurale rezulton një mesatare prej 20.79 minuta. Kur shohim performancën në nivel të përgjithshëm, duket se këto dy kohë janë brenda limiteve prej 15 dhe 30 minutave, varësisht zonës (urbane - rurale), të përcaktuar me PSO. Reagimin më të shpejtë në zonë urbane e kanë DRP-të në Ferizaj e Mitrovicë Jugu, me kohë mesatare prej 8.06, respektivisht 10.32 minuta, derisa më të shtyrë e ka DRP në Mitrovicë Veriu me 15.26 minuta. Sa i përket reagimit në zona rurale, reagimin më të shpejtë gjithashtu e kanë DRP-të në Ferizaj e Mitrovicë Jugu me 13.84, respektivisht 19.92 minuta, derisa reagimin më të vonuar e ka DRP - Mitrovicë Veriu me 32.91 minuta. Sa i përket performancës së stacioneve, shtatë (7) prej 37 sish kanë regjistruar kohë mesatare të reagimit në zonë urbane mbi limitin prej 15 minuta, kurse tetë (8) nga 37 stacione policore kanë regjistruar kohë mesatare të reagimit në zonë rurale mbi limitin prej 30 minutave. Stacionet me reagimin më të shpejtë në zonë urbane janë Rahoveci me 4.8 minuta dhe Shtërpçë me 5.78 minuta. Kurse, reagimin më të shtyrë e kanë Leposaviqi me 37.18 dhe Zubin Potoku me 37.17 minuta (për më tepër referoju shtojcës 2).




1.9. IPK-ja ka analizuar vonesat e shkaktuara mbi limitet e përcaktuara me PSO (maksimum 15 minuta në zonë urbane dhe 30 minuta për zonë rurale). Nga 15.105 mostra të analizuar, në 3.014 sosh reagimet policore kanë qenë jashtë limiteve të përcaktuara me PSO (19.95%). Sipas matjeve për reagimin në zona urbane dhe rurale, del se afërsisht në çdo të pestën thirrje reagohet me vonesë, apo thënë më ndryshe, në 2 nga 10 thirrje të qytetarëve reagohet me vonesë. Siç shihet edhe nga diagrami, DRP në Ferizaj është regjioni ku në zonën e përgjegjësisë së saj është regjistruar mesatarja më e ulët e vonesave në lartësi prej 6.86% për reagimet në zona urbane dhe 6.57% për zonat rurale. DRP - Mitrovicë Veriu është regjioni ku në zonën e përgjegjësisë së saj është regjistruar mesatarja më e lartë e vonesave në lartësi prej 33.21% për reagimet në zona urbane dhe 43.22% për zonat rurale. Sipas matjeve, janë 12 stacione që kanë regjistruar vonesë në reagim mbi mesataren e përgjithshme pa marrë parasysh zonën (më tepër se 2 vonesa në çdo 10 thirrje). Dragashi, Novo Bërda, Prishtinë Veriu, Prishtinë Jugu, Prizren Veriu, Leposaviqi e Zubin Potoku janë shtatë (7) stacione, që kanë regjistruar mesataren më të lartë të numrit të vonesave, duke arritur kuotën afërsisht në 4 vonesa në çdo 10 thirrje (për më tepër referoju shtojcës 2).



1.10. Sipas logut operacional vërehet se sistemi i menaxhimit të informatave dhe komunikimit mundëson evidentimin e thirrjeve sipas tipit. Logu pasqyron dhe tipat e reagimit policor, të pasqyruar si: operacional, aksident, komunikacion, incident, tjera, vepër penale, etj. IPK-ja është interesuar të njihet me reagimin policor sipas këtyre tipave veç e veç. Sipas matjeve të përgjithshme, të bëra nga 15.105 mostra, reagimet më të shpejta bëhen për “aksidentet” me një mesatare të përgjithshme prej 11.42 minuta, kurse më të shtyra bëhen për thirrjet që lidhen me “vepra penale” (17.04 minuta). Sa i përket performances në nivel të drejtorive rajonale, shtatë (7) nga tetë (8) prej tyre reagojnë më shpejtë në rastet “aksidente”, krahasuar me tipat tjerë, kurse në një (1) nga drejtoritë rajonale, reagimet më të shpejta ndodhin për thirrjet që lidhen me “komunikacion”. Sa i përket performancës në nivel stacionesh, rezulton se 22 stacione policore, kohë më të shpejtë të reagimit kanë për thirrjet e tipit “aksident”, dhjetë (10) stacione për thirrjet e tipit “komunikacion” e kështu me radhë. Vetëm dy (2) stacione kanë realizuar një kohë mesatare më të shpejtë për reagimet e tipit “vepër penale”.




1.11. Për të kuptuar kohën mesatare të reagimit për thirrjet e tipit “vepër penale”, IPK ka kategorizuar thirrjet për llojet e veprave penale brenda kapitujve të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Sipas të dhënave në shtojcën 4, shumica e thirrjeve të tipit “vepër penale” lidhen me veprat penale kundër pasurisë” (kapitulli XXVI), veprat penale kundër martesës dhe familjes (XXI) dhe veprat penale kundër jetës dhe trupit (XXVI). IPK ka krahasuar reagimet në përgjigje të thirrjeve të tipit “vepër penale” për të kuptuar prioritetet për reagim në raste. Në diagramin e mëposhtëm pasqyrohet koha mesatare e reagimit në thirrjet e tipit “vepër penale”, si thirrje me frekuencë më të madhe (më të shpeshta në numër janë hasur thirrjet për veprat penale të: kanosjes, atyre që lidhen me narkotikët, sulmet, dhunën në familje dhe vjedhjet). Nga diagrami vërehet se njësitë policore kanë reaguar më shpejt në përgjigje të thirrjeve që lidhen me veprën penale “kanosje”.



1.12. Lidhur me mbajtjen e logut operacional, në stacione policore janë hasur disa dobësi dhe ky inspektim duhet të shtyjë drejtuesit e stacioneve që të standardizojnë metodën e mbajtjes së shënimeve në log:

- (a) Mostra në shumë stacione ka qenë më e ngushtë për shkak të mungesës së të dhënave në log, sidomos llogaritja e kohës së reagimit vështirësohet, ku ka mungesë të dhënash mbi kohën e arritjes së njërive në vendngjarje. Nga kontrolli i logjeve rezulton se një numër stacionesh kanë probleme serioze për mbajtjen e duhur të evidencave mbi kohën e reagimit.
- (b) Kontrolli i logut vë në pah pasqyrë të ndryshme metodash në mbajtjen e evidencës mbi reagimin. Janë hasur stacione që jo plotësisht regjistrojnë informatat në log, megjithëse është evidencë e integruar. Ka stacione që krahas logut të mbajtur në mënyrë elektronike, mbajnë edhe një log fizik të ngjarjeve, duke krijuar regjistrim të dyfishtë.
- (c) Ka dallime varësisht prej stacioneve sa i përket mirëmbajtjes së dosjeve të rasteve në log. Janë hasur situata kur për të njëjtin rast janë gjeneruar disa numra edhe pse kemi të bëjmë me rast të njëjtë. Ka stacione që paraqesin praktika të mira që duhet aplikuar nga stacionet tjera, ku me krijimin e një numri të thirrjes që lidhet me një rast të raportuar, mirëmbahet një dosje në kuadër të të cilit regjistrohen i gjithë aktiviteti (angazhimi) në rast.
- (d) Ka raste kur ka mungesë informatash mbi lokacionin e ngjarjes dhe kjo vështirëson identifikimin e lokacionit, gjë që pamundësohet edhe matja e reagimit policor në vendngjarje (urban apo rural).
- (e) Koha e caktimit të detyrës shpesh përputhet apo është e njëjtë me kohën e arritjes. Është e paqartë nëse ndarja e detyrës ndodhë kur vlerësohet nga mbikëqyrësi se njësitë policore është e gatshme të reagoj, apo kur pranohet thirrja nga regjioni.
- (f) Është hasur kur me mbajtjen e një trajnimit, më pas ka ndryshuar dhe numri i thirrjeve duke rezultuar me ngritje të numrit të rasteve. Ngritjet shqetësim se deri para trajnimit nuk janë regjistruar të gjitha thirrjet. Duhet potencuar trendin e thirrjeve në kuadër të DRP-Prishtinë ku pas trajnimit është shtuar numri i raportimeve për disa herë gjatë vitit të kaluar.

	<p>1.13. IPK-ja është interesuar të njihet edhe me vështirësitë, me të cilat ballafaqohen stacionet policore dhe që mund të ndikojnë në kohën efektive të reagimit policor. Nga informatat e nxjerra nga drejtues të stacioneve policore, IPK-ja ka identifikuar disa faktorë (kushte) që mund të sfidojnë performancën e duhur të njësive policore në përgjigje të thirrjeve të qytetarëve, ku përfshihen, si vijon: mungesa e burimeve njerëzore, mungesa e automjeteve, funksionaliteti jo i duhur i sistemit të radio - komunikimit, probleme në funksionimin e internetit, konfiguracioni gjeografik, etj.</p>
<p>Vlerësimi i përgjithshëm (Përfundim)</p> 	<p>Bazuar në gjetjet e inspektimit, IPK-ja vlerëson se:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✚ Lidhur me mbajtjen e logut nuk është hasur ndonjë udhëzues që jep sqarime se si duhet zhvilluar procedura, nga momenti i pranimin të thirrjes, deri tek arritja dhe raportimi nga vendi i ngjarjes. PSO - Reagimi policor jep një përshkrim të detyrave për qendrat rajonale të komunikimit, por jo edhe të stacioneve. ✚ Çdo vend ka karakteristikat e veçanta, gjë që edhe krahasimi i reagimit me vende të tilla shpesh nuk është i drejtë. Reagimi varet nga një varg faktorësh, përfshirë këtu: burimet njerëzore, logjistikën, numrin e thirrjeve, shtrirjen gjeografike të zonës së përgjegjësisë, etj. Krahasuar me disa qytete në SHBA, ka stacione tek ne që i për afrohen kohës mesatare të reagimit të këtyre vendeve. Kosova duke marrë për bazë kohën e reagimit të stacioneve qëndron më mirë se Shqipëria. ✚ Mirë me kohën e reagimit nuk qëndrojnë të gjitha drejtoritë rajonale/stacionet. Disa prej tyre kanë pasur reagim më të shtyrë apo më të ngathtë, si rezultat i faktorëve që u përmendën. ✚ DRP në Ferizaj duke pasqyruar kohën më të shpejtë të reagimit në nivel vendi, ka dhënë sinjale se modeli i organizimit të qendrës operative të komunikimit së në mënyrën e tanishme është më efektiv në reagim. Stacioni Policor-Ferizaj ka përfituar në shkurtimin e kohës së ndarjes (caktimit) së detyrës, me këtë edhe të reagimit, si rezultat i organizimit të qendrës operative në nivel rajonal. ✚ Stacionet policore janë duke ndjekur mënyra të ndryshme të evidentimit të të dhënave, gjë që edhe pasqyrimi i tyre në log i bën që ato të jenë të dallueshme në përmbajtje (vihet theksi në krijimin e dosjeve të rasteve në log, por edhe mungesës së informacionit mbi aktivitetet). ✚ Logjet tek një numër i madh stacionesh kanë mungesë të dhënash mbi kohën e reagimit, kurse në shumë raste ka mëdyshje nëse koha e caktimit mund të jetë reale (nëse krahasohen logjet e stacioneve policore vërehet se në shumë prej tyre nuk mund të nxirret as mostra e nevojshme për shkak të mungesës së kohës së reagimit). Kjo është rezultat i mungesës së njohurive të nevojshme, por edhe ngarkesës së stacioneve me ngjarje të shumta. ✚ Meqë rezultati mbi ndarjen e detyrës tregon një kohë të shkurtër të caktimit të detyrës, mbetet e paqartë se cili është momenti prej nga fillon periudha e caktimit të detyrës nga mbikëqyrësi, meqë na paraqitet konfuzion, sepse shpesh koha e arritjes është e njëjtë me kohën e caktimit. ✚ Përgjithësisht ngjarjet që lidhen me thirrjet e tipit “aksident” janë përcjellë me kohë më të shpejtë reagimi në raport me tipat tjerë të thirrjeve. Koha e reagimit në thirrjet e tipit “vepër penale”, ndryshon varësisht nga natyra e veprave penale dhe prioriteteve për trajtim. ✚ Duke parë dobësitë evidente tek disa stacione mbi mënyrën si mbajnë logun, trajnimet konsiderohen një mjet i rëndësishëm për avancimin e njohurive në këtë fushë dhe ngritjen e shkathësive të personelit. Krahas kësaj, duhet shtuar edhe kontrolli mbi mbajtësit e evidencave, që informacioni mbi aktivitetet policore të jetë më i plotë dhe i standardizuar.

	<ul style="list-style-type: none"><li data-bbox="400 168 1401 338">✚ Shumë stacione policore mbajnë edhe logun fizik të ngjarjeve ditore dhe habitë fakti pse është i nevojshëm mbajtja e një evidence të dyfishtë, kur dihet se ato janë të obliguara të mbajnë logun operacional përmes sistemit të integruar. Kur janë pyetur përgjegjësit se pse përdorin këto evidenca, ndër arsyet e dhëna është mosfunksionimi i duhur i internetit.<li data-bbox="400 338 1401 495">✚ Shumica e stacioneve policore nuk nxjerrin raporte periodike mbi monitorimin dhe analizën e kohës së reagimit. Duhet të monitorohet reagimi policor, duke siguruar pasqyrë reale mbi angazhimet policore dhe duke identifikuar dobësitë që ndikojnë në krijimin e vonesave në reagim.
--	--

Përmbledhja e rekomandimeve dhe Plani i Veprimit				
Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore	Plani i veprimit
1.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Operacione që të hartojë udhëzues mbi procedurën dhe veprimet e stacioneve, nga momenti i thirrjes, ndarja e detyrës, arritja në vendngjarje dhe raportimi, për të eliminuar dobësitë evidente që reflektojnë nga inspektimi.</i>	-II-	<i>Të gjitha këto janë të rregulluar përmes Rregullores së Operativës dhe njëkohësisht PSO-ve. Të njëjtat nga DSP-ja do të vendosen në një udhëzues të qartë për të gjithë zyrtarët që nga momenti i marrjes së informatës fillestare e deri tek arritja reagimi në vend ngjarje.</i>	K-2 2023
2.	<i>IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve, shefave të operativës dhe mbikëqyrësve të ndërrimeve, të ushtrojnë kontrolle të shtuara, duke përfshirë auditime të planifikuara periodike mbi zyrtarët që mbajnë logun, drejt ngritjes së cilësisë së evidencave.</i>	-I-	<i>DSP-ja do të kërkoj nga DRP-të që të shtojë kontrollin dhe mbikëqyrjen rreth rekomandimit në fjalë dhe për të njëjtën të raportojë në DSP</i>	K-1 2023
3.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Divizionit të Sigurisë Publike (Departamenti për Operacione), që në koordinim me komandantët e stacioneve të organizojnë trajnime të përbashkëta lidhur me mbajtjen e evidencave cilësore (logut), për t'u siguruar se personeli aplikon metodologji unike të regjistrimit në log.</i>	-II-	<i>Drejtori i DSP-së në bashkërendim me DBNJ-në do të organizojë trajnimet e duhura, për të ngritur nivelin e cilësisë lidhur me evidencat e logut, përdorimin e formës unike, etj.</i>	K-2 2023
4.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, si dhe Drejtorit të Departamentit për Shërbime Mbështetëse, që të analizojnë faktorët që sfidojnë reagimin e duhur policor dhe të ndërmarrin veprimet konkrete drejt sigurimit të burimeve të nevojshme (njerëzore dhe logjistike).</i>	-I-	<i>DPPK-ja dhe DSHM-ja pas analizimit të faktorëve, do t'i japin drejtimin e duhur përmes përfshirjes në planifikimin vjetor, do të drejtoj edhe këtë rekomandim sipas mundësive buxhetore.</i>	K-1 2023
5.	<i>IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve dhe shefave të operativës, që të monitorojnë dhe analizojnë kohën e reagimit policor dhe rezultatet t'i dokumentojnë përmes raporteve periodike.</i>	-I-	<i>DSP në koordinim me DPVO-në do të kërkoj nga DRP-të që të përmbledhin të dhënat nga stacionet, të analizojnë shtojnë kontrollin në kuadër të tyre dhe të raportojnë në baza mujore në DSP.</i>	K-1 2023

Shtojca 1 - Indikatorët e performancës së stacioneve mbi reagimin policor të vendngjarje					
Renditja e stacioneve sipas rezultatit	Numri i mostrave	Periudha nga thirrja deri tek caktimi i detyrës	Periudha nga ndarja e detyrës deri tek arritja në vendngjarje	Koha e përgjithshme e reagimit	Reagimi (minuta/ sekonda)
Ferizaj	2.242	1.07	7.42	8.49	8 m 29 s
Mitrovicë Jugu	1.285	0.55	10.66	11.21	11 m 13 s
Gjakovë	544	1.31	10.60	11.91	11 m 55 s
Deçan	80	2.75	9.18	11.93	11 m 56 s
Shtërpce	35	1.83	10.20	12.03	12 m 00 s
Shtime	92	2.12	10.15	12.27	12 m 16 s
Fushë Kosovë	294	2.88	9.71	12.59	12 m 35 s
Gjilan	1.263	0.20	12.53	12.73	12 m 44 s
Prishtinë Qendër	3253	1.32	11.86	13.18	13 m 11 s
Podujevë	503	1.12	12.13	13.25	13 m 15 s
Malishevë	167	0.23	13.48	13.71	13 m 43 s
Klinë	241	3.68	10.12	13.80	13 m 48 s
Prizren Alfa	466	1.43	12.49	13.92	13 m 55 s
Mitrovicë Veriu	184	1.28	12.84	14.12	14 m 07 s
Obiliq	327	1.82	13.34	14.16	14 m 07 s
Graçanicë	274	5.74	8.70	14.44	14 m 26 s
Kaçanik	188	2.21	12.35	14.56	14 m 34 s
Suharekë	316	2.57	12.01	14.58	14 m 35 s
Skenderaj	192	4.26	10.44	14.70	14 m 42 s
Viti	26	2.23	12.89	15.12	15 m 07 s
Vushtrri	464	2.63	13.04	15.67	15 m 40 s
Kllokot	20	2.4	13.45	15.58	15 m 51 s
Lipjan	265	4.72	12.11	16.83	16 m 50 s
Partesh	9	6.56	11.11	17.67	17 m 40 s
Drenas	325	1.31	16.39	17.70	17 m 42 s
Prizren Veriu	113	1.66	16.45	18.11	18 m 07 s
Istog	388	7.23	11.51	18.74	18 m 44 s
Rahovec	159	5.92	14.11	20.03	20 m 00 s
Prishtinë Jugu	407	8.94	11.20	20.14	20 m 08 s
Zveçan	65	2.05	18.12	20.17	20 m 10 s
Pejë	408	60.9	14.47	20.76	20 m 46 s
Kamenicë	29	3.72	19.45	23.17	23 m 10 s
Prishtinë Veriu	195	6.05	19.28	25.33	25 m 20 s
Novo Bërdë	53	5.51	20.58	26.09	26 m 00 s
Zubin Potok	41	5.95	22.44	28.39	28 m 23 s
Dragash	99	7.41	21.41	28.82	28 m 49 s
Leposaviq	93	3.44	27.25	30.69	30 m 41 s
Junik	/	/	/	/	/
Hani i Elezit	/	/	/	/	/
Mamushë	/	/	/	/	/
Ranillug	/	/	/	/	/
Gjithsej	15.105	2.15 min	11.61 min	13.76 min	13 m 46 s

Shtojca 2 - Indikatorët e performancës mbi reagimin policor sipas zonave gjeografike							
Stacionet sipas rezultatit	Koha mesatare e reagimit policor sipas zonave			Përqindja e ngjarjeve ku është reaguar me vonesë			
	Urban	Rural	Gjithsej	Urban	Rural	Gjithsej	Raporti
Ferizaj	8.06	11.37	8.49	6.71	3.09	6.24	10:0.6
Mitrovicë Jugu	10.06	14.99	11.21	16.10	8.33	15.02	10:1.5
Gjakovë	10.26	19.34	11.91	14.16	13.13	13.97	10:1.4
Deçan	7.53	15.90	11.93	5.26	11.90	8.75	10:0.9
Shtërpcë	5.78	14.19	12.03	/	3.85	2.86	10:0.3
Shtime	7.36	16.77	12.27	6.82	10.42	8.70	10:0.9
Fushë Kosovë	11.01	32.09	12.59	21.69	27.27	22.11	10:2.2
Gjilan	11.62	22.59	12.73	20.79	25.00	21.22	10:2.1
Prishtinë Qendër	13.17	19.67	13.18	25.93	16.67	25.91	10:2.6
Podujevë	10.99	18.14	13.25	21.22	14.47	19.09	10:1.9
Malishevë	7.97	17.18	13.71	9.52	8.65	8.98	10:0.9
Klinë	9.39	17.83	13.80	15.65	15.87	15.77	10:1.6
Prizren Alfa	10.96	22.66	13.92	12.93	15.25	13.52	10:1.4
Mitrovicë Veriu	13.90	34.50	14.12	31.32	100.0	32.07	10:3.2
Obiliq	10.79	17.68	14.16	20.96	12.50	16.82	10:1.7
Graçanicë	11.60	16.51	14.44	19.23	11.76	14.60	10:1.5
Kaçanik	8.47	19.17	14.56	11.11	14.95	13.30	10:1.3
Suharekë	10.92	17.72	14.58	19.18	12.35	15.51	10:1.6
Skenderaj	8.95	20.58	14.70	11.34	25.26	18.23	10:1.8
Viti	11.00	19.92	15.12	14.29	25.00	19.23	10:1.9
Vushtrri	9.66	24.25	15.67	15.38	21.99	18.10	10:1.8
Kllokot	16.17	15.38	15.58	8.33	/	5.00	10:0.5
Lipjan	10.45	21.44	16.83	19.82	20.13	20.00	10:2.0
Partesh	8.60	29.00	17.67	/	50.00	22.22	10:2.2
Drenas	13.42	20.41	17.70	25.4	22.61	23.69	10:2.4
Prizren Veriu	15.99	22.64	18.11	45.45	22.22	38.05	10:3.8
Istog	10.73	24.19	18.74	16.56	23.81	20.88	10:2.1
Rahovec	4.80	25.46	20.03	27.16	33.33	30.19	10:3.0
Prishtinë Jugu	20.20	14.50	20.14	47.15	/	46.68	10:4.7
Zveçan	18.79	21.59	20.17	36.36	18.75	27.69	10:2.8
Pejë	14.63	25.42	20.76	29.55	29.74	29.66	10:3.0
Kamenicë	10.93	34.60	23.17	14.29	33.33	24.14	10:2.4
Prishtinë Veriu	19.83	31.63	25.33	43.27	43.96	43.59	10:4.4
Novo Bërdë	16.42	34.10	26.09	41.67	34.48	37.74	10:3.8
Zubin Potok	16.00	37.17	28.39	35.29	54.17	46.34	10:4.6
Dragash	11.22	32.73	28.82	22.22	45.68	41.41	10:4.1
Leposaviq	18.88	37.18	30.69	39.39	50.00	46.24	10:4.6
Junik	/	/	/	/	/	/	/
Hani i Elezit	/	/	/	/	/	/	/
Mamushë	/	/	/	/	/	/	/
Ranillug	/	/	/	/	/	/	/
Gjithsej	11.62 m	20.79 m	13.76 m	20.15%	19.30%	19.95%	10:2.0
Mostra	11.571	3.534	15.105	2.332	682	3.014	

Shtojca 3 - Indikatorët e performancës mbi reagimin policor sipas tipit të thirrjes (ngjarjes)						
Stacionet sipas rezultatit	Mostra	Aksident	Komunikacion	Incident	Tjera	Vepër penale
Ferizaj	2.242	7.83	8.39	8.25	8.36	10.70
Mitrovicë Jug	1.285	8.51	11.55	11.34	12.16	12.11
Gjakovë	544	8.87	11.42	12.40	12.13	13.81
Deçan	80	8.42	12.50	10.19	21.44	12.88
Shtërpcë	35	15.50	7.50	17.83	19.33	11.69
Shtime	92	7.69	6.86	12.00	13.59	15.58
Fushë Kosovë	294	9.29	16.75	10.30	11.93	13.76
Gjilan	1.263	10.35	13.46	12.31	13.49	12.82
Prishtinë Qendër	3.253	11.51	14.30	11.63	13.38	14.97
Podujevë	503	10.54	10.89	13.69	12.37	17.67
Malishevë	167	10.93	21.20	19.15	13.77	14.25
Klinë	241	9.11	10.00	17.56	14.05	22.17
Prizren Alfa	466	12.78	14.64	13.77	14.21	14.56
Mitrovicë Veriu	184	13.13	10.20	14.38	15.33	14.34
Obiliq	327	11.91	13.55	13.23	10.00	18.09
Graçanicë	274	12.90	10.57	15.11	17.41	18.36
Kaçanik	188	12.35	8.09	11.67	14.45	22.22
Suharekë	316	11.34	18.29	16.21	13.38	16.77
Skenderaj	192	10.45	9.77	17.60	14.40	19.69
Viti	26	5.75	9.75	9.50	19.11	20.00
Vushtrri	464	11.08	16.93	11.71	15.56	19.96
Kllokot	20	5.25	20.00	23.78	1.00	12.20
Lipjan	265	12.84	18.36	19.34	14.77	19.90
Partesh	9	8.00	11.00	16.00	/	25.33
Drenas	325	14.67	16.73	16.22	17.01	28.97
Prizren Veriu	113	13.52	18.00	19.68	15.36	20.42
Istog	388	12.67	23.55	15.39	19.66	25.24
Rahovec	159	15.50	21.57	18.91	21.29	24.34
Prishtinë Jug	407	18.72	25.24	18.74	21.66	18.37
Zveçan	65	13.60	11.00	16.38	26.90	21.89
Pejë	408	17.31	24.95	18.56	20.60	22.92
Kamenicë	29	12.20	9.00	18.92	16.75	48.17
Prishtinë Veriu	195	23.70	36.44	20.29	27.32	19.37
Novo Bërdë	53	25.80	31.00	20.00	26.75	30.65
Zubin Potok	41	15.00	12.50	25.00	35.00	32.33
Dragash	99	20.07	21.00	33.34	23.35	38.52
Leposaviq	93	24.50	23.38	36.52	24.00	37.91
Junik	/	/	/	/	/	/
Hani i Elezit	/	/	/	/	/	/
Mamushë	/	/	/	/	/	/
Ranillug	/	/	/	/	/	/
Gjithsej	15.105	11.42	13.28	13.95	13.69	17.04

Shtojca 4 - Pasqyrë përmbledhëse mbi kohën mesatare të reagimit në thirrjet e qytetarëve sipas tipit “vepër penale”, të kategorizuara sipas kapitujve të Kodit Penal të Republikës së Kosovës	
Kapitulli	Reagimi (minuta)
Veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare	12.25
Vepra penale kundër jetës dhe trupit	13.39
Vepra penale kundër lirisë dhe të drejtave të njeriut	14.43
Vepra penale kundër martesës dhe familjes	15.27
Veprat penale të narkotikëve	14.1
Vepra penale kundër ekonomisë	22.6
Vepra penale kundër pasurisë	18.13
Vepra penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore	38.17
Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë	13.75
Vepra penale të armëve	17.03